



# HEIDELBERGCEMENT

[www.springalive.net](http://www.springalive.net)

## **Roli i konkursit të mësuesve "Pse ne kemi nevojë për qytetarët që kontribuojnë në shkencë?"**

1. Konkursi organizohet nga BirdLife International.
2. Ky konkurs është i hapur për mësuesit e shkollave publike dhe private që janë të angazhuara me aktivitetet e grupeve të fëmijëve të Spring Alive.
3. Mësuesit e pranishëm duhet të mbajnë orë mësimore me nxënësit e shkollave në çdo formë (në distancë/ mësim online, klasa, mësim në natyrë ose të alternuara me aktivitete) me temën kryesore të Spring Alive 2022: "Kontributi i qytetarëve në shkencë për shpendët". Ato nuk duhet të jenë më pak se 10 nxënës të angazhuar në aktivitetet e paraqitura nga konkursi.
4. Dosja:

Për të marrë pjesë në konkurs pjesmarrësit duhet të paraqesin një përshkrim të orëve mësimore të zhvilluara në klasë dhe rezultatet (psh. Punët e fëmijëve) për partnerët ndërkombëtarë BirdLife në vendin e pjesmarrësit.

Përshkrimi duhet të përgatitet në format elektronik, psh në prezantime PDF ose Power Point ose video, ku duhet të shpjegohen ideja e mësimit në klasë, aktivitetet të cilat do të mbahen dhe rezultatet e arrira. Fotografitë, puna e fëmijëve, plani i mësimit dhe materialet e tjera që tregojnë rezultatet e mësimeve janë shumë të rëndësishme të përfshihen në dosje.

Partnerët ndërkombëtarë BirdLife do të ndajnë dosjet e çdo kandidati me Menaxherin kombëtar Spring Alive.
5. **Kohëzgjatja dhe dita e mbylljes:** Pjesmarrësit duhet të rregjistrohen nga data 1 Mars – 21 Qershor.
6. Çdo pjesmarrës mund të dërgojë vetëm një herë dosjen e tij/saj.
7. Aplikanti duhet të sjellë të dhënat e mëposhtme në dosje: emri i plotë, adresa, numri i telefonit, emri i shkollës ose institucionit ku mësuesi/ja punon dhe adresa postare.
8. Dorëzimi i dosjes do të mundësojë përdorimin e të dhënave personale nga BirdLife International.
9. Pjesmarrësit që nuk lejohen të marrin pjesë në konkurs janë: Puntorët e organizatës të cilët koordinojnë këtë konkurs nga Spring Alive dhe familjet e këtyre punonjësve.
10. Juria  
Paneli i jurisë do të ketë këto përfaqësues:
  - Karolina Kalinowska – Menaxhere e International Spring Alive
  - Shane Sparg - Conservation Partnership Manager, Stichting BirdLife Europe
  - Një person i përzgjedhur nga personeli i zyrës HeidelbergCement



# HEIDELBERGCEMENT

[www.springalive.net](http://www.springalive.net)

Vendimet e panelistëve janë të formës së prerë dhe nuk do të lejohen ndërhyrje në procesin e vendimarrjes. Organizatorët kanë të drejtën të zëvendësojnë ose shtojnë anëtarët e jurisë nëse e shikojnë të nevojshme.

## 11. Çmimet:

Vendi 1: mikroskop

Vendi 2: teleskop

Vendi 3: udhëzues shpendësh

Vendi 4: udhëzues shpendësh

Organizatorët kanë të drejtën të zëvendësojnë një çmim me vlerë të përafërt ose për të ndryshuar çmimet nëse e shikojnë të nevojshme.

## 12. Rezultatet

Rezultatet e konkursit do të publikohen në [www.springalive.net](http://www.springalive.net) në datën 31 qershor 2022. Fituesit e konkursit do të informohen gjithashtu me një email të veçantë për çmimin e fituar nga partnerët ndërkombëtarë BirdLife.

## 13. E drejta e autorit:

Pjesëmarrësit e konkursit, duhet të bien dakord që BirdLife International dhe partnerët kombëtarë kanë të drejtë të publikojnë, në çdo format, punime të paraqitura për konkursin.